



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E BUXHETIT

U D H E Z I M

NR.16, DATE 20.07.2011

MBI

ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 463, DATE 16.06.2011 TE KESHILLIT TE
MINISTRAVE

Ne zbatim te vendimit nr.463, date 16.06.2011, "Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimit nr. 511, date 24.10.2002, te Keshillit te Ministrave, "Per kohezgjatjen e punes dhe te pushimit ne institucionet shteterore", pika 5 e Kreut 1 dhe pika 2 e Kreut II , Ministri i Financave,

U D H E Z O N :

I- Mbi punen e kryer mbi kohen normale

1. Nepunesit/punonjesit ne administraten publike, ne raste te vecanta dhe te domosdoshme, mund ti kerkohet nga titullari i institucionit te punoje mbi kohen normale te punes per kryerjen e nje detyre te caktuar. Oret e punes mbi kohen normale te punes kompesohen brenda 2 muajve me pushim te barabarte me oret shtese te kryera plus 25 per qind te tyre, kur keto ore jane kryer ne dite te zakonshme pune apo me oret shtese te kryera plus 50 per qind te tyre, kur oret jane kryer ne dite pushimi, dite feste apo nga ora 22.00-6.00.
2. Per te kryer nje detyre te caktuar jashte kohes normale te punes per te gjitha punonjesit e administrates, titullari i institucionit miraton urdherin perkates per detyren qe duhet te kryhet, kohezgjatjen e saj dhe punonjesit qe ngarkohen ne kryerjen e kesaj detyre. Njesite e personelit ne bashkepunim me eprorin e punonjesit qe caktohet te punoje jashte kohes normale te punes, marrin masat e duhura per te siguruar realizimin e detyres se caktuar, si dhe per te percaktuar kohen e kryerjes se pushimit te perlllogaritur sipas pikes 1 te ketij udhezimi. **Ne asnje rast, punonjesi i administrates publike qe kryen veprimtari administrative nuk kompesohet financiarisht** per kohen e punuar mbi kohen normale te punes, por kompesohet vetem me ore/dite pushimi.
3. Nepunesi dhe punonjesi i administrates qe kryen **veprimtari operacionale**, si rregull, kompesohet me ore/dite pushimi. Mund te kompesohen financiarisht punonjesit qe kryejne veprimtari te drejtperdrejte operacionale vetem kur plotesohen dy kushtet e meposhtme:
 - a) kur eshte e pamundur dhenia e pushimit per oret shtese te punuara, per shkak te natyres se veprimtarise operacionale, nderprerja e se ciles cenon funksionalitetin e institucionit,

- b) kur institucioni ka fonde te miratuara per kete qellim ne buxhetin vjetor te tij.
4. Me veprimtari operacionale, ne kuptim te ketij vendimi konsiderohen ato veprimtari te cilat kane nje kohezgjatje te panderprere (sistem 24 oresh/sistem gadishmerie) si dhe veprimtaria e mesimdhenies ne arsimin e larte universitar. Ne raste specifike, merret miratimi i Ministrimit te Financave.
 5. Masa maksimale e kompesimit financiar si dhe menyra e llogaritjes se tij, behet sipas legjislacionit ne fuqi. Masa e kompesimit perfshihet ne listpagesen e muajit kur jane kryer oret shtese.
 6. Planifikimi i fondeve te nevojshme per ore te punuara mbi kohen normale te punes, behet gjate procesit te hartimit te projektbuxhetit te vitit pasardhes dhe regjistrohet ne databazen e pagave te Ministrise se Financave per cdo ministri dhe institucionit qendror buxhetor. Kërkesa per planifikimin e fondit perkates dhe regjistrimi i tij ne databaze, behet ne nivel ministrie dhe institucioni qendror dhe paraqitet nga titullari i ministrise/institucionit qendror, duke dhene argumentet mbi pamundesine e kompesimit fizik me ore/dite pushimi te oreve te punuar mbi kohen normale te punes.

II- Mbi kryerjen e pushimeve vjetore pjesore

7. Nepunesi/punonjesi i administrates publike gezon te drejten e kryerjes se pushimit vjetor te paguar. **Nuk lejohet kompesimi financiar i pushimit vjetor te pakryer.**
8. Per kryerjen e pushimeve vjetore te paguara, nepunesi/punonjesi i administrates publike pas miratimit paraprak nga eprori i tij, kerkon prane njesise se personelit, pushimin e tij vjetor duke percaktuar qarte ditën e fillimit dhe kohezgjatjen e tij. Kjo kerkese behet efektive per punonjesin pas miratimit me shkrim nga njesia e personelit te institucionit.
9. Nepunesi/punonjesi i administrates publike ka te drejte te kerkoje kryerjen e pushimit vjetor te paguar edhe ne periudha te ndryshme e te ndara ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Kur punonjesi kerkon kryerjen pjesore te ketij pushimi, kjo periudhe nuk mund te jete me pak se 6 dite ne vijim dhe ne cdo rast te pushimeve pjesore dita e fillimit dhe perfundimit nuk mund te jete dite e shtune apo e djele. Keshtu, nese nje punonjes i merr pushimet vjetore pjesore deri ne dy jave kalendarike, dita e fillimit dhe perfundimit te pushimit pjesor do te jete dite pune.
10. Ngarkohet njesia perkatese e personelit te monitoroje grafikun e pushimeve vjetore per cdo punonjes dhe te njoftoje punonjesin dhe eprorin e tij ne rastet kur punonjesi nuk ka kryer plotesisht pushimin vjetor. Ky njoftim behet brenda dates 30 dhjetor te vitit aktual dhe per cdo rast qe konstatohet se nuk eshte kryer plotesisht pushimi vjetor, njesia e personelit ne bashkepunim me eprorin e punonjesit, miratojne skedulimin e diteve te mbetura te pushimit vjetor, te cilat duhen detyrimisht te kryhen deri me 31 mars te vitit te ardhshem.
11. Udhezimi nr.19, date 10.07.2008 “Për vendosjen e disa standarteve ne planifikimin e shpenzimeve per personelin”, shfuqizohet.

RIDVAN BODE

MINISTER I FINANCAVE